

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mediat ruse e serbe e paraqesin protestën në Tiranë si “trazira” për shkak të dënimit të ish-krerëve të UÇ K-së
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/mediat-ruse-e-serbe-e-paraqesin-protesten-ne-tirane-si-trazira-per-shkak--i587232
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 10:10:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 10:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	09bca16a8a3ae41701f780d08d69da1bf750dfa10f42796fc8d72ef6277dee32
TEKSTI	efad90942638a404fa770fa15e15ee2fe6bcfc1cf3d160efa2eb2b481a809095
PAMJA	b2b86867ce860ca92b7c1c0c342532012e93d3bdf7bdf3a32c787c753762e16e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ca1575dc243e11580a9ad39425ea67987fd4d7b8d3ae8c18bee075ae806671ec
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ca1575dc243e11580a9ad39425ea67987fd4d7b8d3ae8c18bee075ae806671ec>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



9.2 milione turiste ne tete muaj, fluks rekord ne Rinas! Demo alenderon Policine Kuhtare: Presim edhe me shume vizitore "Paketa e Maleve" per agroturizmin, Rama sqar fundit

Mediat ruse e serbe e paraqesin protestën në Tiranë si “trazira” për shkak të dënimit të ish-krerëve të UÇK-së



20 Shtator 2026, 12:20Rajoni TEMA



Përmes një artikulli të publikuar më 17 shtator nga mediumi rus “Sputnik” në gjuhën serbe, pretendohet se në Tiranë kanë ndodhur “trazira” për shkak të aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

Artikulli mban titullin “Trazira në Tiranë për shkak të aktgjykimit ndaj udhëheqësve të të ashtuquajturës UÇK: Shqipëria doli në krah të Prishtinës”.

Në artikull pretendohet se deputetët e Kuvendit të Shqipërisë miratuan një deklaratë lidhur me aktgjykimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Më tej, pretendohet se “pranë parlamentit” kanë ndodhur përleshje mes policisë dhe protestuesve, të cilët, sipas artikullit, ishin mbledhur në protestë “kundër qeverisë së kryeministrit Edi Rama dhe kundër vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë” ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

I njëjti artikull u publikua më pas edhe nga mediumi në serbisht “Vaseljenska.net”.

Pas hulumtimit online të kryer nga hibrid.info, u vërtetua se raportimet e mediave në Shqipëri tregojnë se protesta e 17 shtatorit në Tiranë ishte pjesë e një serie protestash antiqeveritare që kishte nisur rreth 110 ditë më herët dhe kërkesa kryesore e protestuesve ishte dorëheqja e kryeministrit Edi Rama.

Raportimi i mediave në Shqipëri

Mediumi online Reporter.al raportoi se qindra qytetarë u mbledhën pranë Kuvendit dhe Ministrisë së Brendshme, duke kërkuar largimin e Ramës. Sipas këtij raportimi, protestuesit hodhën vezë dhe letra higjienike drejt policisë, ndërsa tensionet u përshkallëzuan kur disa prej tyre tentuan të kalonin kordonin policor dhe gardhin metalik. Më pas, pati përplasje kur një pjesë e protestuesve u nisën drejt Kryeministrisë.

Edhe BalkanWeb raportoi se protestuesit e mbledhur para Kuvendit bënin thirrje kundër klasës politike dhe kërkonin dorëheqjen e Edi Ramës.

Raportimi i Shqiptarja.com përshkruan gjithashtu se protesta e 17 shtatorit nisi para Kuvendit dhe më pas u zhvendos në zona të tjera të Tiranës. Sipas këtij mediumi, tensionet e para me policinë nisën kur protestuesit tentuan të kalonin kordonin e policisë pranë Ministrisë së Brendshme, pas së cilës pati hedhje vezësh dhe shisesh uji drejt efektivëve.

Pra, përplasjet me policinë më 17 shtator lidhen në raportimet e mediave shqiptare me protestën antiqeveritare dhe tentativat e protestuesve për të kaluar barrierat policore, ndërsa nuk gjendet në këto raportime dëshmi se përplasjet u shkaktuan nga kundërshtimi ndaj aktgjykimit të Hagës.

Po vendimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së?

Është e vërtetë se më 17 shtator Kuvendi i Shqipërisë miratoi një deklaratë lidhur me aktgjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Në deklaratë Kuvendi shprehu mospajtim me vendimin dhe deklaroi se do të bashkërendojë veprimet me institucionet e Kosovës.

Po ashtu, BalkanWeb raportoi se kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi, lexoi deklaratën në mbështetje të UÇK-së dhe ish-pjesëtarëve të saj.

Megjithatë, kjo ishte një ngjarje e ndarë nga protesta antiqeveritare jashtë Kuvendit. Madje, raportimet për protestën e 17 shtatorit tregojnë se ajo ishte paralajmëruar si protestë kundër klasës politike dhe se protestuesit kërkonin dorëheqjen e Ramës.

Ndërsa më 16 shtator, ditën kur u shpall aktgjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së, protesta e qytetarëve në Tiranë u solidarizua edhe me ta. Euronews Albania raportoi se protesta e 109-të përkoi me shpalljen e vendimit në Hagë dhe se protestuesit gjatë marshimit drejt Kryeministritë brohoritën “UÇK, UÇK”.

Faktet tregojnë se më 17 shtator në Tiranë pati përplasje mes protestuesve dhe policisë, por këto përplasje ndodhën gjatë një proteste antiqeveritare që ishte zhvilluar prej rreth 110 ditësh. Pra, burimet nga mediat në Shqipëri nuk e mbështesin pretendimin e mediumit rus se përplasjet me policinë u shkaktuan për shkak të aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së. /thegeopost.com

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Pas Hagës, kush do ta çojë përpara drejtësinë për krimet e luftës në Ballkan?

09:50 Rajoni

Diaspora shqiptare në protestë për ish-krerët e UÇK-së, tubime në Mynih dhe Këln

08:32 Rajoni / 3 komente

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Prishtina në protestë për të katërtën natë radhazi

08:10 Rajoni / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.